

Total: (224016) Pershendetje Vizitor | [Kreu](#) | [Identifikohuni](#) | [Regjistrohuni](#) | [Na Shkruani](#)

Lajme

... arkiva informative

03/11/2010, "PARAJSA.COM" 9

- [Politike](#)
- [Sport](#)
- [Kulture](#)
- [Biznesi](#)
- [Teknologjia](#)
- [Intervista](#)
- [Shendeti](#)
- [Rajoni](#)
- [Shqipëria](#)
- [Kosova](#)
- [Bota](#)
- [Big Brother](#)
- [ViP](#)
- [Moda](#)

[Parajsa.com](#)[Forum](#)

USAID ndihmon të rinjtë të gjejnë punësim profesional

Kendi i Reklamave



USAID ndihmon të rinjtë të gjejnë punësim profesional
[Огласи Google-a](#) [Gazeta](#) [Albania](#) [RTK Le](#)



Prishtinë, 2 nëntor 2010 - Mbështetja e USAID-it ofuar për trajnimin dhe programet e praktikës për studentët e universitetit, ka rezultuar në punësimin profesional të 75 të rinjve.

Mark Wood, Drejtor i KPEP-it ka theksuar se USAID-i e konsideron zhvillimin e fuqisë punëtore si strategji kryesore në përmirësimin e pozitës konkurruese të kompanive dhe sektorëve të Kosovës.

Pasi që e gjithë ekonomia e Kosovës sipas tij po lëviz drejt shekullit 21, konkurrenca në treg, zhvillimi i shkathtësive për pjesëmarrësit aktualë dhe të ardhshëm të fuqisë punëtore dhe qasja e studentëve dhe e të papunëve në vende pune e profesione të reja, do të jetë kërkesë thelbësore.

"Për t'u ofuar studentëve, të papunëve dhe të punësuarve aktualë shkathtësitë të cilat i përshtaten më mirë biznesit, Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë ka organizuar disa programe të praktikës" tha Wood.

- Trajnimi dhe programi i praktikës në kontabilitet dhe financa, i implementuar nga Shoqata për Shërbime Financiare dhe Kontabilitetit (AFAS), ka inkuadruar 103 studentë të ekonomisë. Këta studentë kanë ndjekur programin e trajnimit dhe u vendosën si praktikantë nëpër banka dhe institucione mikrofinanciare. Deri më sot, 59 studentëve u janë vazhduar kontratat.

- Nga programi i praktikës për fusha të ndryshme, i implementuar nga World University Service Austria (WUS Austria), përfituan 40 studentë. Këta studentë u vendosën në ministri dhe drejtori të ndryshme komunale të pesë komunave. Deri më tani, 2 prej tyre u është ofuar mundësi punësimi permanent.

- Programi i praktikës për sektorin e prodhimeve të qumështit, i implementuar nga Nisma për Zhvillim të Bujqësisë së Kosovës (IADK), ka inkuadruar 15 praktikantë: 10 studentë fillestare dhe 5 mentorë, të cilët ishin zgjedhur nga pilot grupi i programit të vitit 2009. Programi prapë dëshmoi të jetë shumë i suksesshëm për shkak se edhe cilësia e qumështit të prodhuar nga fermerët, që ishte po ashtu pjesë e programit, është përmirësuar, si dhe

- Programi i praktikës për industrinë e përpunimit të drurit, i implementuar nga Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPDK), i angazhoi 16 studentë nga Fakulteti i Shkencave Aplikative dhe nga Shkolla Profesionale dhe të Zdrukthëtarisë dhe Qendra për Afësim Profesional, të gjithë klientë të KPEP-it.

Ky projekt ishte shumë i suksesshëm për shkak se 16 studentëve u është ofuar punësim nga kompanitë ku ishin të vendosur për praktikë. Deri më sot, 14 prej tyre i kanë pranuar ofertat për punë.

Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë i USAID-it është një nismë katër vjeçare e filluar në tetor 2008 dhe synon stimulimin e afësisë konkurruese të sektorit privat në ekonominë e Kosovës.



lajme.parajsa.com

1 reitw eet

Like

Be the first of your friends to like this.

Kerkoni

Komentoni artikullin

Emri:

E-Mail:

Te gjitha materialet e publikuara ne kete faqe permbajne burimin e tyre si edhe adresen e artikullit origjinal, ne kete menyre ruhet dhe respektohet e drejta e autoreve perkates, paraqitja e tyre ne faqen tone eshte thjesht informativ, per perdorimin e ketyre materialeve ju lutemi kontaktoni autoret perkates!

Te gjitha te drejtat dhe shpallimet u perkasin: